



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit, nr. 03/L - 040, për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor, 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2022, merr këtë

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE
"HORTIKULTURA", SHA, PRISHTINË

I.

MIRATOHET Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura", SHA, Prishtinë.

II.

Shuma e mjeteve të ndara sipas pikës I të këtij vendimi, është 100.000 € (njëqind mijë euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, programi i Administratës së përgjithshme, mjete nga të hyrat vetanake.

III.

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare si në pikën II, për nevojat e ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura", SHA, Prishtinë, në përmisimin e kushteve dhe ofrimin sa më efikas të shërbimeve.

IV.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/02-236765/22, më 28.10.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupa

